

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE
“Luxury Service Group” SH.P.K
ME SELI NË TIRANË

Sot, më datë 28/12/2020, në Tiranë,

Z. Florin Qemali, shtetas shqiptar, lindur Durres me 17/09/1979, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me karte identiteti nr H90917061R

I cili ka vendosur themelimin e shoqërisë “**Luxury Service Group**” **SH.P.K**, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me termat e mëposhtme:

NENI 1

SHOQËRINË TREGTARE “**Luxury Service Group**” **SH.P.K**, është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, (në vazhdim Shoqëria).

Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar . Shoqëria ka selinë e saj në Tiranë dhe do të mund të vendos ose heq seli sekondare, zyra sekondare perfaqesimi dhe agjenci në shqipëri edhe jashtë shtetit.

NENI 2

Emri i shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **Luxury Service Group**

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka për objekt - në përputhje me kërkesat ligjore - veprimtaritë e mëposhtme: Prodhim I produkteve teknologjike dhe zhvillimi i projekteve per ndertim.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në Durres, Lagjia Iliria, nr 13.

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakut të vetëm themelues të kësaj Shoqërie në para në vlerën 100 (njëqind) lek, dhe është 1 (një) kuote. Themeluesi merr në pronësi kuoten e tij në kapitalin themeltar në përputhje me kontributin e tij.

Kontributi i ortakut themelues në kapitalin themeltar është si më poshtë:

Z. Florin Qemali 1 kuote , me vlerë 100 Lek, zotëron 100 % (njëqind).

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktiviteti fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar. Aktivitete tregtare mbyllen në datën 31 dhjetor të çdo viti. Aktiviteti i parë tregtar do të mbyllet në datën 31 dhjetor 2020.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të vetëm ;
2. Administratorët .

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet fillimisht nga Administratori i vetem i cili zgjidhet me afat pesëvjeçar të ripërtërishëm përveç rasteve të revokimit ose të dorëheqjes ose shkaqeve të tjera ligjore.

Administratori i Shoqërisë i cili pranon do të jetë **Z. Florin Qemali**, shtetas shqiptar, lindur Durres me 17/09/1979, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me karte identiteti nr H90917061R

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

Shoqëria është e administruar nga një administrator i vetëm, edhe jo ortak ose nga shumë administrator, edhe jo ortak, sipas asaj që është përcaktuar në aktin e emërimit.

Kur administrimi i shoqërisë i është besuar disa personave, akti i emërimit vendos në alternative që:

- a) nëse administratorët do të veprojnë në mënyrë kolegjiale duke themeluar kështu këshillin e administrimit
- b) nëse administrimi është caktuar bashkarisht ose jo bashkarisht.

NENI 8

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 9

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 10

Ligji i aplikueshëm

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga ortaku themelues dhe të legalizohet përpara noterit ditën e themelimit, sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me themelimin e Shoqërisë do të zgjidhen nga Ortaku i vetëm, në rast të kundërt do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

NENI 12

Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi hartohet në tre kopje në gjuhën shqipe dhe atë Italiane dhe u lexua nga Ortaku Themelues i cili e gjeti atë në përputhje me vullnetin e tij të lirë dhe e nënshkroi pa vërejtje dhe Noteri e legalizon nënshkrimin.

Ky akt themelimi u përkthye edhe në gjuhën italiane prej përkthyesit të autorizuar nga Ministria e Drejtësisë **Egli Haxhiraj** të njohur dhe pranuar nga palët.

ORTAKU THEMELUES

Z. Florin Qemali

FLORIN QEMALI

